

**RREGULLORE
PËR PUNËSIMIN, LARGIMIN NGA PUNA DHE VLERËSIMIN E
PERSONELIT AKADEMIK, NDIHMESAKADEMIK DHE
ADMINISTRATIV TË “TBU“**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligj që në vijim do të përmendet me shkurtimin L-AL, në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë si dhe në Statutin dhe Rregulloren për Programet e Studimit dhe Procesit Mesimor.

Neni 2

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave bazë për punësimin, vlerësimin dhe largimin nga puna të personelit akademik dhe ndihmës-akademik të njëjësive bazë, si dhe personelit administrativ në TBU.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregulloreje është e zbatueshme për personelin akademik, ndihmës-akademik, personelin e ftuar si dhe atë administrativ të punësuar pranë TBU. Personel akademik është ai personel që kryen veprimtari mësimore, kërkimore dhe veprimtari të tjera në ndihmë të këtyre proceseve dhe të institucionit ashtu si përcaktohet në L-AL.

Neni 4

Parime të përgjithshme

- Rekrutimi i stafit akademik në TBU mund të jetë me kohë të plotë ose me kohë të pjeshme.
- Pavarësisht natyrës së punësimit detyrimet ndaj procesit mësimor janë të njëjta dhe përzgjedhja bëhet mbi të njëjtat kritere.

- Personeli akademik që kërkohet mund të ketë titujt akademik ashtu si përcaktohet në nenin 59 të L-AL, me eksperience akademike dhe eksperiencë në drejtim të institucioneve dhe / ose shoqërive tregëtare.
- TBU, në mbështetje të strategjisë së lidhjes së teorisë me praktikën, synon të aktivizojë staf që kombinon përgatitjen akademike me përvojën praktike.
- TBU nuk bën dallime midis kandidatëve me kualifikim shkencor dhe akademik brenda dhe jashtë vendit. Diskriminimet që lidhen gjithashtu me racën, besimin fetar, seksin, origjinën krahinore apo shoqërore janë të papranueshme në politikën e rekrutimit të stafit akademik, ndihmës-akademik dhe atij administrativ.
- Kriteri i integritetit të kandidatit është i rëndësishëm dhe mund të jetë vendimtar në pranimin ose refuzimin e një kandidature. Kandidatët me precedentë penalë, me reputacion publik të dëmtuar, me moral të diskutueshem, të dështuar në pozicionet e tyre të mëparshme të punës do të skualifikohen nga shqyrtimi për rekrutim.

KREU II

PUNËSIMINI I STAFIT AKADEMIK

Neni 5

Proçedura e përzgjedhjes së kandidatit me konkurs

- Punonjësit e stafit akademik me kohë të plote ose të pjesëshme të TBU si rregull pranohen me konkurs. Kriteret specifike të konkurimit për të dyja kategoritë propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga Dekani. Këto kritere i përcillen Rektorit për miratim.
- Konkursi shpallet me vendim të Rektorit dhe publikohet në faqen zyrtare të TBU. Shpallja e vendeve të lira duhet të përmbajë të gjitha informatat përkatëse për çdo pozicion, duke përfshirë, por pa u kufizuar domosdoshmerisht në detajet, një përcaktim të kriterëve të kualifikimit për pozicionin e shpallur, si dhe afatin për dorëzimin e kërkesës. Çdo kërkesë regjistrohet pranë sekretarisë mësimore të TBU.
- Për zhvillimin e konkursit, Rektori ngre një komision vlerësimi të përbërë nga përfaqësues të departamentit, të fakultetit dhe të TBU. Komisioni i vlerësimit harton dhe i paraqet Rektorit për miratim pikët e vlerësimit për çdo kriter të vecantë. Konkursi zhvillohet në afatet e përcaktuara të shpallura publikisht në faqen zyrtare të TBU.
- Të gjithë kandidatët që i plotësojnë kriteret për pozicionin e shpallur do të intervistohen. Komisioni i vlerësimit do të zbatojë kritere të njëjta në vlerësimin e kandidateve dhe intervistimin e tyre do ta zbatojë bazuar në materialet që ndodhen në dosjen e kandidatit.
- Pasi të bëhet vlerësimi për secilin kandidat të intervistuar për pozicionin përkatës, të

gjithë kandidatët do të renditen sipas rezultatit zyrtar përfundimtar. Vetëm kandidatët, rezultati përfundimtar i të cilëve do të jetë "shumë mire", do të rekomandohen për emërim.

- Në raste të vecante, kur kandidati është një figurë e njohur me ekspertizë shumë të vlefshme për fushën e veçantë për të cilën kërkohet nga TBU, punësimi i tij nuk kalon nëpër procesin e paraqitur në këtë nen, por si rregull janë drejtuesit e njësive kryesore që i bëjnë propozim Rektorit për punësimin e tij.

Neni 6

Punësimi i kandidatit

Vendimi përfundimtar për punësimin e kandidatit i takon Rektorit të TBU. Komisioni i vlerësimit i paraqet raportin e vet Rektorit për të vepruar më tej. Nëse Rektori miraton kandidat të përzgjedhur nga komisioni, pas intervistës me të dhe nëse bie dakort nënshkruan kontratën e punës me kandidatin fitues.

Pranimi i punonjësve mësimore të huaj bëhet me propozim të drejtuesve të njësive kryesore dhe vendim të Rektorit.

Marrëdhënia e punës rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës. Kontrata Individuale e Punës specifikon përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e palëve, të gjithë elementët e tjerë që kanë lidhje me ngarkesën mësimore të kandidatit të punësuar, periudhën e provës, si dhe kohëzgjatjen e dhe përfundimin e kontratës së punës.

KREU III

VLERËSIMI, MASAT DISIPLINORE DHE LARGIMI NGA PUNA I PERSONELIT AKADEMIK

Neni 7

Vlerësimi i personelit akademik

Vlerësimi në punë i personelit akademik bëhet si rregull nga drejtuesi i njësisë bazë përkatëse. Drejtuesi i njësisë bazë bën një vlerësim final për çdo personel të stafit të tij në fund të çdo semestri dhe në fund të çdo viti akademik.

Per kryerjen e këtij vlerësimi drejtuesi i njësisë bazë mund të ndjekë orët e mësimin të personelit, të shikojë disiplinën në punë dhe gjithashtu komunikimin me studentët. Vlerësimi i bëhet e ditur personelit pas kryerjes së tij, pas çdo semestri dhe në fund të vitit akademik.

Vlerësimi i rezultateteve në punë kryhet me qëllim të rritjes së cilesise të punës dhe për të siguruar përmirësimin gradual të aftësisë profesionale dhe të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në TBU. Rezultatet e vlerësimit të punës përdoren për të siguruar të dhënat e nevojshme për stafin akademik me qëllim përmirësimin e punës së tyre dhe gjithashtu ato merren parasysh gjatë procedurave disiplinore, apo largimit nga puna.

Neni 8

Masat disiplinore

Stafi akademik i TBU do t'u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje që kanë lidhje me mos respektimin e kontratës së punës, Kodit të Etikës, dhe rregulloreve të tjera të shkollës.

Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në përpjestim me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e stafit akademik. Për shkelje të lehta vendosen masat disiplinore si vërejtje me gojë ose vërejtje me shkrim që vendoset në dosjen personale të personelit akademik. Për shkelje të rënda –serioze vendosen masat disiplinore si pezullimi apo largimi nga puna.

Në të gjitha rastet kur shkelja është e rëndë, përpara se ceshtja ti drejtohet Rektorit për ndërprerje përfundimtare të marrëdhënieve të punës, drejtuesi i njësive bazë organizon në departament një diskutim për shkeljen e konstatuar në prani të gjithë stafit pjesëmarrës të departamentit si edhe të drejtuesit të njësive kryesore. Në këtë diskutim personi i cili ka bërë shkeljen ka mundësi të dëgjohet dhe të diskutojë për rrethanat e shkeljes në departament.

Punëdhënësi mund të zgjidhë kontratën për një shkak të justifikuar, në çdo kohë, pa afat njoftimi (në mënyrë të menjëhershme) por duke respektuar procedurën. Në kontratën e punës janë të përcaktuara qartë se cilat janë shkaqet e justifikuar.

Neni 9

Largimi nga puna

Ndërprerja e marrëdhënies së punës me vendim të njëanshëm bëhet kur TBU ose personeli akademik merr iniciativë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Nëse ndërprerja e marrëdhënieve të punës kërkohet nga personeli akademik, afati i njoftimit për dorëheqje është të paktën një 1 muaj.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës kërkohet nga TBU për shkak të performancës dhe rezultateve të dobëta, dhe shkeljeve të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje dhe në kontratën e punës.

KREU IV

PUNËSIMINI I STAFIT NDIHMËS-AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

Neni 10

PUNËSIMI, VLERËSIMI DHE LARGIMI NGA PUNA

Mënyra e konkurrimit dhe përzgjedhja e personelit ndihmës-akademik dhe atij administrativ bëhet sipas dispozitave të Kodit të punës, ashtu si përcaktohet në Statutin e TBU.

Punësimi dhe largimi nga puna i Administratorit të TBU dhe Administratorëve të fakulteteve bëhet sipas neneve 12 dhe 14 të Statuti të TBU.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11

Aprovimi, ndryshimi dhe hyrja në fuqi

Kjo rregullore propozohet nga Rektori dhe miratohet nga Senati. E drejta për interpretim dhe amendim i kësaj rregulloreje i takon Senatit Akademik. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Senati.